



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 44 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr.03/L-040, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 38 paragrafët 1 dhe 2 të Statutit të Komunës së Podujevës, nr.01-020/01-0050862/19, dhe nenit 25.2 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Komunës së Podujevës, nr.01/146-11 të datës 29 prill 2010,

Në kërkesë të Kryetarit të Komunës së Podujevës, nr.prot.01-060/01-0046624/21 të datës 10 qershor 2021,

THËRRAS

Mbledhjen e L-të (pesëdhjetë, mandati VI) e jashtëzakonshme, të Kuvendit të Komunës së Podujevës, e cila do të mbahet më **15 qershor 2021, në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e Komunës së Podujevës, në orën 10:00, me këtë:**

Rend dite

- 1. Kërkesë për nismën e procedurës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit me Qytetin / Komunën Kestel të Regjionit të Bursa në Republikën e Turqisë**
 - *Propozim Vendimi për miratimin e Kërkesës-Nismës së Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar-Binjakëzimit me Qytetin / Komunën Kestel të Regjionit të Bursa në Republikën e Turqisë.*
 - *Propozim Vendimi për Autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për Bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar-Binjakëzim me Qytetin/Komunën Kestel të Regjionit të Bursa në Republikën e Turqisë.*
- 2. Kërkesë për nismën e procedurës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit me Qytetin / Komunën Linz të Republikës së Austrisë**
 - *Propozim Vendimi për miratimin e Kërkesës-Nismës së Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar-Binjakëzimit me Qytetin / Komunën Linz të Republikës së Austrisë.*
 - *Propozim Vendimi për Autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për Bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar-Binjakëzim me Qytetin/Komunën Linz të Republikës së Austrisë.*

Mbledhja mbahet duke respektuar masat sipas vendimeve dhe akteve tjera të nxjerra nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe rekomandimeve të IKSHPK lidhur me situatën nga Pandemia Covid-19

Nr. 01-060/03-0046888/21
Podujevë,
10 qershor 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Për: Kuvendin e Komunës
z.Fatmir Gashi, Kryesues i Kuvendit

Çështja: Kërkesë për mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit

Kërkoj nga Kryesuesi i Kuvendit që në bazë të nenit 44 paragrafi 1 të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 6 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.02/2015 për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës, nenit 38 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.prot.01-020/01-0050862/18, si dhe në pajtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit, të thërras mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës, me pikat e rendit të ditës:

- *Nismën e procedurës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit me Qytetit / Komunës Kestel të Regjionit të Bursa në Republikën e Turqisë*
- *Nismën e procedurës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit me Qytetit / Komunës Linz të Republikës së Austrisë*

Kjo kërkesë për mbledhje të jashtëzakonshme bëhet për shkak të afateve të përcaktuara ligjore që ndërlihen me mbajtjen e mbledhjeve dhe shqyrtimit administrativ të ligjshmërisë së akteve të Kuvendit të Komunës.

Vlen të potencohet se si delegacion kemi qenë në vizitë zyrtare në Bursa të Republikës së Turqisë dhe janë ndërmarrë iniciativa konkrete për lidhjen e bashkëpunimit të ndërsjellë me Qytetit / Komunën Kestel.

Po ashtu, pas zhvillimit të bisedave kohë më parë me Kryetarin e Linz të Republikës së Austrisë, më 02 qershor 2021 kemi pranuar ftesën e z.Klaus Luger, Kryetar i Qytetit Linz të Republikës së Austrisë për vizitë në këtë qytet më 01 korrik 2021, me qëllim të inicimit të bashkëpunimit konkret të ndërsjellë mes dy qyteteve / Komunave.

Andaj mbi këto fakte, kërkohet të mbahet mbledhje e jashtëzakonshme e Kuvendit të Komunës në mënyrë që edhe nga ana e Komunës së Podujevës të ndërmerren hapa konkret procedural drejt binjakëzimit me qytetet / Komunat e lartëcekura.

***Bashkëngjitur:** Kërkesat për nismën e procedurës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit me Qytetet/Komunat e cekura, propozim vendimet përkatëse dhe dokumentacionin tjetër të nevojshëm.*

Nr.prot.01-060/01-0046624/21
Podujevë, 10 qershor 2021





Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Për: KUVENDIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

Çështja: Kërkesë për nismën e procedurës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit

Të nderuar/a,

Në cilësinë e Kryetarit të Komunës në kuadër të objektivave programore për mundësitë e bashkëpunimit me komuna dhe qytete ndërkufitare jashtë Republikës së Kosovës, përkatësisht për vendosjen e bashkëpunimit të ndërsjellë, kam bërë bisedat paraprake dhe më pastaj kam zhvilluar edhe takime preliminare me përfaqësuesit e

➤ **Qytetit / Komunës Kestel të Regjionit të Bursa në Republikën e Turqisë,**

Sa për njoftim, në ftesë të përfaqësuesve të Qytetit / Komunës së **Kestel në Bursa**, delegacioni i Komunës së Podujevës i kryesuar nga Kryetari i Komunës, drejtori i Drejtorisë së Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, si dhe anëtarët tjerë të stafit mbështetës, kemi zhvilluar vizitë zyrtare në Qytetin Bursa

Gjatë vizitës, si delegacion jemi pritë nga shumë përfaqësues të institucioneve publike dhe private si dhe jemi informuar rreth përvojave dhe praktikave të ndryshme sa i përket menaxhimit të institucioneve lokale publike për sektorë të caktuar si dhe në fusha të tjera të rëndësishme të interesit të përgjithshëm, pritje të cilat në saje të bashkëpunimit preliminar ishin mjaft të frytshme dhe me një interesim maksimal në funksion të marrjes së hapave konkret për zyrtarizimin dhe formalizimin e bashkëpunimit të ndërsjellë mes komunave/qyteteve respektive.

Gjithashtu si Kryetar i Komunës së Podujevës, kam ftuar zyrtarisht përfaqësuesit e Qytetit të cekur për vizitë në Komunën e Podujevës me qëllim të njohjes më përse afërmi për fushat dhe sektorët ku ne si dy qytete/komuna mund të bashkëpunojmë në të ardhmen.

Duke marrë për bazë këtë si dhe ndërtimin e marrëdhënieve të ndërsjella mes dy Qyteteve, kërkoj nga Kuvendi i Komunës së Podujevës të miratoj nismën e procedurës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit me Qytetin / Komunës **Kestel të Regjionit Bursa në Republikën e Turqisë,**

Vlen të theksohet se Qyteti në fjalë tash më ka ndërmarrë veprime konkrete procedurale në funksion të bashkëpunimit dhe binjakëzimit me Komunën e Podujevës.

Shtojcë:

- *Propozim vendimi për miratimin e nismës së bashkëpunimit komunal ndërkombëtar – binjakëzim me Qytetin / Komunën e **Kestel të Regjionit të Bursa në Republikën e Turqisë.***
- *Propozim vendimi për autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për binjakëzim me Qytetin / Komunën e **Kestel të Regjionit të Bursa në Republikën e Turqisë.***

Me respekt

Nr.prot.01-016/01-0046630/21
Podujevë,
10 qershor 2021



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 40 shkronja j) dhe 58 shkronja h) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit për bashkëpunim ndërkombëtar nr.04/L-010, nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores së MAPL-së për procedurën e bashkëpunimit ndërkombëtar nr.0203-1334 të datës 18.12.2012, dhe nenit 34 paragrafi 2.10 dhe 61 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/19, Kuvendit të Komunës, i,

PROPOZON

VENDIM

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS – NISMËS SË BASHKËPUNIMIT KOMUNAL NDËRKOMBËTAR – BINJAKËZIMIT ME QYTETIN / KOMUNËN KESTEL TË REGJIONIT TË BURSA NË REPUBLIKËN E TURQISË

Neni 1

Kuvendit të Komunës së Podujevës i propozohet për miratim kërkesa – nisma e Kryetarit të Komunës së Podujevës, për vendosjen e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar – binjakëzimit me Qytetin / Komunës Kestel të Regjionit të Bursa në Republikën e Turqisë.

Neni 2

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës, me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës do të autorizohet për fillimin e konsultimeve me përfaqësuesit e Qytetit / Komunës Kestel të Regjionit të Bursa në Republikën e Turqisë, dhe përgatitjen e draft Marrëveshjes për bashkëpunim të ndërsjellë.

Neni 3

Pas miratimit dhe hyrjes në fuqi, Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Podujevë,
10 qershor 2021



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 40 shkronja j) dhe 58 shkronja h) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit për bashkëpunim ndërkombëtar nr.04/L-010, nenit 6 paragrafi 3 të Rregullores së MAPL-së për procedurën e bashkëpunimit ndërkombëtar nr.0203-1334 të datës 18.12.2012, dhe nenit 34 paragrafi 2.10 dhe 61 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/19, Kuvendit të Komunës, i,

PROPOZON

VENDIM

PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË KOMUNËS PËR FILLIMIN E KONSULTIMEVE PËR BASHKËPUNIM KOMUNAL NDËRKOMBËTAR – BINJAKËZIM ME QYTETIN / KOMUNËN KESTEL TË REGJIONIT TË BURSA NË REPUBLIKËN E TURQISË

Neni 1

Kuvendit të Komunës së Podujevës i propozohet që, z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës, të autorizohet për fillimin e konsultimeve për vendosjen e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit në mes të Komunës së Podujevës dhe Qytetit / Komunës Kestel të Regjionit të Bursa në Republikën e Turqisë

Neni 2

Të identifikohen interesat e përbashkëta dhe në pajtim reciprok, konform legjislacionit në fuqi, të përgatitet draft Marrëveshja për bashkëpunim të ndërsjellë mes dy Qyteteve/Komunave.

Neni 3

Draft Marrëveshja sipas nenit paraprak të këtij vendimi, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës së Podujevës, pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Pushteti Lokal.

Neni 4

Pas miratimit dhe hyrjes në fuqi, Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Podujevë,
10 qershor 2021



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KRYETARI I KOMUNËS

Për: KUVENDIN E KOMUNËS SË PODUJEVËS

Çështja: Kërkesë për nismën e procedurës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit

Të nderuar/a,

Në cilësinë e Kryetarit të Komunës në kuadër të objektivave programore për mundësitë e bashkëpunimit me komuna dhe qytete ndërkufitare jashtë Republikës së Kosovës, përkatësisht për vendosjen e bashkëpunimit të ndërsjellë, kam bërë bisedat paraprake përmes platformës online me z.Kalus Luger, Kryetar i,

➤ **Qytetit Linz të Republikës së Austrisë,**

Sa për njoftim, gjatë zhvillimit të bisedave jemi dakorduar që të kemi vizita paraprake mes delegacioneve të dy Qyteteve / Komunave, dhe në këtë kontekst më 02 qershor 2021 kemi pranuar ftesën e z.Klaus Luger, Kryetar i Qytetit Linz të Republikës së Austrisë, (siç mund ta shihni në dokumentin e bashkëngjitur kësaj kërkesë)

Duke marrë për bazë këtë si dhe ndërtimin e marrëdhënieve të ndërsjella mes dy Qyteteve, kërkoj nga Kuvendi i Komunës së Podujevës të miratoj nismën e procedurës për bashkëpunim komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit me Qytetin / Komunën Linz të Republikës së Austrisë.

Vlen të theksohet se, sipas kontakteve dhe bazuar në ftesën e Kryetarit të Qyteti në fjalë tash më ka ndërmarrë veprime konkrete procedurale në funksion të bashkëpunimit dhe binjakëzimit me Komunën e Podujevës.

Shtojcë:

- *Propozim vendimi për miratimin e nismës së bashkëpunimit komunal ndërkombëtar – binjakëzim me Qytetin / Komunën e **Linz të Republikës së Austrisë.***
- *Propozim vendimi për autorizimin e Kryetarit të Komunës për fillimin e konsultimeve për binjakëzim me Qytetin / Komunën e **Linz të Republikës së Austrisë.***

Me respekt

Nr.prot.01-016/01-0046634/21
Podujevë,
10 qershor 2021



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 40 shkronja j) dhe 58 shkronja h) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit për bashkëpunim ndërkombëtar nr.04/L-010, nenit 6 paragrafi 2 të Rregullores së MAPL-së për procedurën e bashkëpunimit ndërkombëtar nr.0203-1334 të datës 18.12.2012, dhe nenit 34 paragrafi 2.10 dhe 61 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/19, Kuvendit të Komunës, i,

PROPOZON

VENDIM

PËR MIRATIMIN E KËRKESËS – NISMËS SË BASHKËPUNIMIT KOMUNAL NDËRKOMBËTAR – BINJAKËZIMIT ME QYTETIN / KOMUNËN LINZ TË REPUBLIKËS SË AUSTISË

Neni 1

Kuvendit të Komunës së Podujevës i propozohet për miratim kërkesa – nisma e Kryetarit të Komunës së Podujevës, për vendosjen e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar – binjakëzimit me Qytetin / Komunën Linz të republikës së Austrisë.

Neni 2

z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës, me vendim të veçantë të Kuvendit të Komunës do të autorizohet për fillimin e konsultimeve me përfaqësuesit e Qytetit / Komunës Linz të Republikës së Austrisë, dhe përgatitjen e draft Marrëveshjes për bashkëpunim të ndërsjellë.

Neni 3

Pas miratimit dhe hyrjes në fuqi, Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Podujevë,
10 qershor 2021



Kryetari i Komunës
Shpejtim Bulliqi



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYETARI I KOMUNËS

Në bazë të nenit 40 shkronja j) dhe 58 shkronja h) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit për bashkëpunim ndërkombëtar nr.04/L-010, nenit 6 paragrafi 3 të Rregullores së MAPL-së për procedurën e bashkëpunimit ndërkombëtar nr.0203-1334 të datës 18.12.2012, dhe nenit 34 paragrafi 2.10 dhe 61 paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-020/01-0050862/19, Kuvendit të Komunës, i,

PROPOZON

VENDIM

PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË KOMUNËS PËR FILLIMIN E KONSULTIMEVE PËR BASHKËPUNIM KOMUNAL NDËRKOMBËTAR – BINJAKËZIM ME QYTETIN / KOMUNËN LINZ TË REPUBLIKËS SË AUSTRISË

Neni 1

Kuvendit të Komunës së Podujevës i propozohet që, z.Shpejtim Bulliqi, Kryetar i Komunës së Podujevës, të autorizohet për fillimin e konsultimeve për vendosjen e bashkëpunimit komunal ndërkombëtar në formën e binjakëzimit në mes të Komunës së Podujevës dhe Qytetit / Komunës Linz të Republikës së Austrisë.

Neni 2

Të identifikohen interesat e përbashkëta dhe në pajtim reciprok, konform legjislacionit në fuqi, të përgatitet draft Marrëveshja për bashkëpunim të ndërsjellë mes dy Qyteteve/Komunave.

Neni 3

Draft Marrëveshja sipas nenit paraprak të këtij vendimi, nënshkruhet nga Kryetari i Komunës së Podujevës, pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Pushteti Lokal.

Neni 4

Pas miratimit dhe hyrjes në fuqi, Vendimi hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës, përkatësisht konform nenit 81 të ligjit për vetëqeverisje lokale nr.03/L-040, dhe nenit 8.11 të Rregullores (QRK) nr.01/2016 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave.

Podujevë,
10 qershor 2021



Klaus Luger
Bürgermeister

LinZ
verändert

GZ: 2021/9.5580386
bitte bei Antwort anführen

Linz, June, 2nd, 2021

Mayor
Univ.-Prof. Dr. Shpejtim Bulliqi
dr.shkelzensinani@hotmail.com

Dear Mr. Mayor Prof. Dr. Shpejtim Bulliqi,

It is a great pleasure for me to invite you very cordially to an official visit to the city of Linz on the occasion of the signing of a Letter of Intent between our two cities on July 1st, 2021. I would be very pleased if you could accept my invitation, because we here in Linz are particularly interested in strengthening cooperation between our two cities.

We will be happy to put together a program during your visit to suit your wishes. On this occasion we could also discuss possible cooperation agreements.

In anticipation of a personal meeting, I remain in the meantime with best regards from Linz.

Yours truly,



Klaus Luger
Mayor